



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada-Government**



*Ministria e Mbrojtjes*  
*Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense*

**Drejtoria e Burimeve Njerëzore/Direktorat Ljudskih Resurs/Human Resources Directorate**

Bazuar në nenin 5, paragrafi 1.3 i Rregullores Nr.07/2023 për Rekrutim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, si dhe duke pasur për bazë ofertën nga Republika Federale e Gjermanisë, Ministria e Mbrojtjes shpall:

**K O N K U R S I B R E N D S H Ë M**

Për pranimin e 6 kandidatëve për shkollim në:

**-Republika Federale e Gjermanisë;**

- Në degën e artilerisë - dy (2) kandidat;
- Në degën IT ushtarake - dy (2) kandidat;
- Në degën e Zbulimit (rikonicionit) - dy (2) kandidat.

**PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE PËRZGJEDHJES PËR SHKOLLIM NË INSTITUCIONET USHTARAKE TË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË**

**Kandidati që aplikon për shkollim në institucionet ushtarake të Republikës Federale të Gjermanisë duhet:**

- Të jetë pjesëtar i FSK-së;
- Të ketë zotësi të plot për të vepruar ;
- Të ketë të përfunduar nivelin e studimeve Bachelor;
- Të zotërojë aftësitë e nevojshme shëndetësore dhe fizike për vendin e shërbimit;
- Të mos jetë i dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;
- Të njohë gjuhën e vendit pritës;
- Të ketë figurë të pastër dhe të mos kenë probleme dëbimi nga shtetet tjera;
- Të jetë i moshës 18 deri në moshën 30 vjeçare në datën e mbylljes së konkursit;
- Të ketë gjatësi trupore jo më pak se 165 cm për meshkuj dhe 160 cm për femra.
- Të mos kenë tatuazhe në fytyrë, qafë dhe parakrah nga pjesa e bicepsit e deri te gishtat e dorës duke përfshirë edhe pirsingun; (Kandidatët të cilët bartin tatuazhe në fytyrë, qafë dhe parakrah nga pjesa e bicepsit e deri te gishtat e dorës duke përfshirë edhe pirsingun, në rast përzgjedhje janë të obliguar të bëjnë heqjen e tyre paraprakisht në afatin kohor; deri në fillimin e shkollimit për kadet, në të kundërtën do të diskualifikohen);

**Testet që aplikohen për pranim në institucionet ushtarake të Republikës Federale të Gjermanisë:**

- Testi fizik;
- Testi i inteligjencies dhe testi i njohurive të përgjithshme;
- Intervista;
- Ekzaminimi shëndetësor;

**Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

- Diploma universitare;
- Ekstrakti i lindjes (jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj);

- Certifikata nga gjykata dhe policia për të kaluarën e tyre penale (dokumenti të jete i nxjerrë brenda afatit të konkursit);
- Kopje të letërnjoftimit apo pasaportës;
- Foto portret 4x4 për aplikim (elektronike);
- Kontrata e FSK-së

#### **Shënim:**

***Kriteri i njohjes së gjuhës së vendit pritës/gjuhës gjermane do t'u mundësohet kandidatëve të arrihet përmes kursit të gjuhës gjermane të organizuar nga Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes në Forcën e Sigurisë së Kosovës i cili është kusht për t'u përzgjedhur në shkollimet e ofruara nga institucionet ushtarake të Republikës Federale të Gjermanisë.***

#### **E drejta në ankesë**

- Të drejtën e ankesës e ka çdo kandidatë pas marrjes së rezultateve të çdo faze të testimit përkatës.
- Rezultatet publikohet në ueb-faqen e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK dhe kandidatet e eliminuar kanë të drejtë ankese brenda afatit 2 ditor. Afati i ankesës rrjedh ditën pasuese pas publikimit të rezultatit.

#### **KUSHTET TJERA:**

- Për t'u marrë në konsideratë gjatë aplikimit, diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës, duhet t'i nënshtrohen procesit të njohjes nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
- Pjesëtarët e FSK-së të cilët përzgjidhen për studime në Akademitë/Institucionet ushtarake brenda dhe jashtë vendit marrin statusin e kadetit dhe realizojnë pagën e kadetit të FSK-së deri në përfundimin e studimeve.
- Pjesëtarët e FSK-së të cilët përzgjidhen për studime në Akademitë/Institucionet ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe marrin statusin e kadetit, në rast të dështimit në përfundimin e studimeve, i nënshtrohen kriterëve sanksionuese të kontratës duke kthyer mjetet e investuara, mirëpo i ofrohet mundësia të kalojë në gradën paraprake të shërbimit.
- Kadetët/pjesëtarët e FSK-së që ndjekin shkollimin në Akademitë ushtarake jashtë vendit, janë të obliguar të shërbejnë dyfishin e kohës së shkollimit, e cila rregullohet dhe përcaktohet me kontratë.
- Dhënia e informatave të rrejshme kurdo që zbulohet, gjatë procesit të rekrutimit apo gjatë shërbimit në FSK, rezulton me largim nga FSK-ja.

#### **Afati i konkurrimit;**

- Konkursi do të jetë i hapur prej **20.01.2026** deri më **29.01.2026, ora 23:59.**

#### **Si të aplikoni;**

Aplikimi dhe njoftimi për kandidatët e FSK-së është online në adresën <https://rekrutimi.fsk-rks.org/Apply> si dhe njoftimi për shpalljen e konkursit mund ta shikoni edhe në Web faqen e MM-së, <https://mod.rks-gov.net>, ku gjendet shpallja e konkursit. **Kandidatët plotësojnë formularin e aplikimit online <https://rekrutimi.fsk-rks.org/Apply> dhe bashkëngjisin të gjitha dokumentet tjera të kërkuara nga ky formular.** Kandidatet kanë të drejtë të aplikojnë deri në ditën e fundit të përmbylljes së konkursit. Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në nr. Tel.038- 555584 dhe 038- 551005, nga ora 09:00 deri 15:00.

**Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja ofron trajtim të barabartë për të gjithë pjesëtarët e FSK-së dhe mirëpret aplikacionet e tyre, pa dallim nga përkatësia etnike apo gjinore.**